

Emri i Projektit:	Terminali detar i Vlores
Shteti:	Shqiperi
Numri i projektit:	35351
Spektori:	Transport
Publik/Privat:	Privat
Kategoria e mjedisit:	A
Data e bordit:	18 Mars 2008
Statusi:	Ka marre miratimin fillestar, duhet te marre miratimin final
Data e mbylljes te PSD:	1 Nentor 2007
Data e perditesimit te PSD:	

Pershkrimi i projektit dhe objektivat: Projekti i propozuar konsiston ne nje hua prej 15 milion Euro per Petroliferen Italo-Shqiptare per ndertimin e nje terminali te ri detar per trajtimin e produkteve te naftes jashte Vlores, ne Shqiperine e jugut. Projekti permban depozita per depozitimin e naftes, benzines dhe gazit te lengshem si dhe infrastrukturen e nevojshme e detare per funksionimin e terminalit qe pefshin molin dhe kalatat.

Ndikimi ne tranzicion: Ndikimi ne tranzicion pritet te vije nga administrimi privat fokusuar mbi klientin i infrastruktures logjistike, sherbimi ne perputhje me standartet nderkombetare, paraqitja e nje modeli qe mund te coje ne replikimin e projekteve te ngjashme ne rajon, si dhe hapjen e tregjeve te lidhura si tregetia e produkteve te naftes dhe gazit te lengshem.

Klienti: Petrolifera Italo-Shqiptare eshte nje kompani private qe eshte pronesi e Petroliferes Italo-Rumune. Kompania ka fituar te drejtat te ndertoje dhe te vendose ne funksionim pajisjet mes nje kontrate afatgjate.

Financimi i BERZH: Huaja e propozuar afersisht 15 milion Euro.

Kostoja totale e projektit: 50 milion Euro.

Ndikimi ne mjedis: **Kategorite ndarese dhe arsyet e klasifikimit**

Projekti perfshin ndertimin e nje terminali te ri bregdetar per perpunimin e produkteve te naftes (ku perfshihen nafta dhe benzina), gaz i lengshem (LPG) dhe produktet e tjera te lengshme, kryesisht kimike. Sipas Politikes Mjedisore te BERZH, projekti eshte klasifikuar si A/1

Due diligence, perfundimet dhe masat lehtesuese

Eshte pergatitur nje Vleresim i Ndikimit mbi Mjedis (VNM) dhe eshte paraqitur ne publik si pjese e procedurave te Bankes. Ceshtjet e

rendesishme mjedisore, te sigurise dhe sociale te identifikuara dhe per te cilat jane marre masat lehtesuese jane si me poshte:

- Dherat e ndotur;
- Cilesia e ajrit
- Ndotja e ujit nen toke dhe ne siperfaqe;
- Mbetjet;
- Trafiku;
- Trafiku detar
- Zhurma dhe lekundjet

Ndikimet e parashikuara do te zbuten ne ne pjesen me te madhe nepermjet zgjidhjeve teknike qe permbahen ne planin e projektit, si p.sh sistemi i mbledhjes dhe perpunimit te lendeve organike te paqendrueshme, kapake te dyfishte dhe te levizshem per depozitat etj., dhe gjithashtu mes masave te tjera lehtesuese si p.sh trajtimi i ujit dhe ujrave te zeza te ndotur me nafte, plani i gerryerjes, plani i ndertimit etj. Vendi eshte perdorur me pare si nje vend per hedhjen e mbetjeve te nje fabrike kimike ne afersi (Fabrika e sodes dhe PVC-se). Studimi mjedisor perfshin nje kerkim te detajuar per te percaktuar shtrirjen e ndotjes. Toka e ndotur do te depozitohet ne menyre te sigurt nen disa zona te shtruara per te evituar ndotjen e metejshme. Ndikimet grumbulluese dhe nderkufitare jane vleresuar gjithashtu si pjese e procesit te VNM. Gjithashtu eshte zhvilluar nje Plan Menaxhimi dhe Monitorimi Mjedisor per te lehtesuar ndikimet negative te identifikuara.

Ne faqen e internetit te BERZH eshte publikuar nje Permbledhje e VNM qe permban nje perskrim te plote te ndikimeve te rendesishme te identifikuara dhe masave lehtesuese te planifikuara.

Publikimi i informacionit dhe konsultimi

Nje Plan i Konsultimit Publik dhe Publikimi (PKPP) eshte pergatitur si pjese e procesit te VNM. Disa artikuj gazetash e publikuan projektin ne pranveren e 2003 pas prezantimit te tij tek zyra e kryeministrit. Faza e pare e konsultimit dhe publikimit eshte kryer gjate konsultimeve te para publike te bera gjate vitit 2004 me nje prezantim te detajuar te projektit final tek te gjitha palet e interesuara te autoriteteve lokale, banoreve dhe paleve te tjera te interesuara ne zonat e ndikuara. Me pas u zhvillua nje takim i dyte me komunitetin e Vlores ne 23 gusht 2005. Ne fazen e dyte te

konsultimeve publike dhe procesit te publikimit, drafti i VNM iu paraqit publikut ne 18 tetor 2007. Nga kjo date, kopje te draftit te plote te Raportit te VNM dhe kopje te Permbledhjes jane vene ne dispozicion te publikut per rishikim ne vende te ndryshme ne faqen e internetit te Petroliferes Italo-Shqiptare.

Bashkepunimi teknik :

Asnje.

Per mundesi konsultimi per projekte te financuara nga fondet teknike per bashkepunim vizitoni [procurement of consultants](#).

Kontakti i kompanise:

La Petrolifera Italo Albanese Sh.A.
Bulevardi Zhan d'Ark
Kulla Jeshile Teknoprojekt no. 2, ap. 1
1614 Tirana
Albania

Tel: +355 4 250 736

Fax: +355 4 250 735

E-mail: pia@gruppopir.com

Website: www.gruppopir.com

Kontaktet e BERZH:

Alessia di Domenico, Operation Leader:
domenica@ebrd.com

Mundesi per biznes:

Per mundesi per biznes ose prokurim,
kontaktoni kompanine.

Pyetje te pergjithshme:

Pyetje per projekte te BERZH qe nuk lidhen
me prokurimin:

Tel: +44 20 7338 7168; Fax: +44 20 7338
7380

Email: projectenquiries@ebrd.com